



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

JETA FAMILJARE NË ISLAM

Hurshid Ahmed

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

NË VEND TË PARATHËNIES.....	5
I. QASJA E ISLAMIT NDAJ JETËS: THEMELET.....	7
TEVHIDI - NJËSIA E ZOTIT	8
MËKËMBËSIA E NJERIUT	9
RRUGA E PËRSOSUR NË JETË.....	14
BESIMI - THEMEL I SHOQËRISË.....	16
II. FAMILJA NË ISLAM.....	17
PARIMET THEMELORE.....	17
INSTITUCION HYJNISHT I FRYMËZUAR	17
MARRËVESHJA SHOQËRORE.....	19
FEJA DHE FAMILJA.....	20
MARTESA	21
BARAZIA NDËRMJET GJINIVE.....	22
III. FAMILJA	23
DETYRAT DHE QËLLIMET E SAJ	23

A. RUAJTJA DHE VAZHDIMËSIA E RACËS NJERËZORE.....	23
B. MBROJTJA E MORALIT	24
C. STABILITETI PSIKO-EMOCIONAL, DASHURIA DHE MIRËSJELLJA.....	26
D. SIGURIMI SHOQËROR DHE EKONOMIK.....	30
DH. ZGJERIMI E HORIZONTIT FAMILJAR DHE KONTRIBUTI I KOHEZIONIT SHOQËROR NË BASHKËSI.....	34
E. MOTIVI PËR PËRPJEKJE DHE SAKRIFICË	34
IV. FAMILJA.....	37
STRUKTURA, PARIMET DHE RREGULLAT	37
BASHKËSIA MARTESORE DHE SHKURORËZIMI.....	37
MARRËVESHJA MARTESORE	40
STRUKTURA E FAMILJES MUSLIMANE.....	43
FAREFISNIA E GJERË FAMILJARE	43
POZITA E BURRIT DHE E GRUAS	45
FAMILJA DHE SHOQËRIA.....	47

NË VEND TË PARATHËNIES

Libërthi i Ahmed Hurshidit: JETA FAMILJARE NË ISLAM, i ndarë në katër kapituj:

- I. Qasja e Islamit nda jetës - themelet,
- II. Familja në Islam (parimet themelore),
- III. Familja, detyrat dhe qëllimi dhe
- IV. Familja, struktura, parimet dhe rregullat

me nëntitujt e tyre, ofrojnë një pasqyrë të qartë për themelimin, kultivimin, mbajtjen, ruajtjen, rregullimin dhe ndërtimin e familjes mbi parimet e shëndosha morale të Islamit.

Duke e çmuar familjen si bërthamën e parë të organizimit shoqëror, ku kultivohen dashuria e respekti i ndërsjellë, jo vetëm ndërmjet çiftit bashkëshortor por edhe ndërmjet anëtarëve të tjerë të familjes, vëllezërve e motrave, e që shkon duke u degëzuar në familjen e gjerë farefisnore, ku përfshihen edhe axhallarët, dajallarët, hallat e tezët, nipat e mbesat - dashuria e respekti rrezatojnë e zgjerohen në mbarë shoqërinë. Prandaj, familja konsiderohet si gjëja më e shenjtë dhe më e shtrenjtë, prej nga përhapen njerëzishmëria, kultura e civilizimi gjithënjëzë.

Familja, sipas autorit, është një institucion shoqëror hyjnisht i frymëzuar, që nuk zhvillohet sipas proceseve eksperimentale, por me anë të martesës së vetëdijshme, që është obligim edhe ndaj

Zotit edhe ndaj shoqërisë. Familja krijohet me anë të martesës. Prandaj Islami, për të ndaluar çdo formë të marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore, preferon martesën si institucion i familjes, që luan rol të rëndësishëm në shoqërinë islame.

Me rastin e martesës parashihen detyrat dhe obligimet e çiftit bashkëshortor, nga njëra anë, mirëpo njëkohësisht edhe me rastin e shklorëzimit këshillohet që të mos cenohen të drejtat njerëzore të asnjërës palë, nga ana tjetër, sepse familja është rregullator që e stabilizon shoqërinë njerëzore.

Familja gjatë shtimit të saj përjeton edhe degëzimin e trungut të saj gjenealogjik të një gjaku e të një fisi, pjesëtarët e të cilës nuk kanë të drejtë të martohen ndërmjet veti.

Duke e lexuar këtë libërth të shkurtë, lexuesi mëson se si ta ruajë pastërtinë morale: individuale, familjare dhe shoqërore, prandaj këshillohet që ta ruajë këtë vlerë të lartë morale, duke e fisnikëruar veten me virtyte të larta njerëzore. Por, ai ka për detyrë që njëkohësisht ta fisnikërojë dhe ta edukojë edhe familjen e vet, duke kontribuar kështu në përsosjen e vlerave morale dhe njerëzore në të gjitha shoqëritë. Kështu ai i përmbush detyrat e obligimet e familjes në Islam, plotëson edhe dëshirën e All-llahut xh.sh. dhe zbaton porosinë e Pejgamberit të Tij, Muhammedit a.s.

Përkthyesi: Mehmet Halimi

I. QASJA E ISLAMIT NDAJ JETËS: THEMELET

Ne jemi duke jetuar në një kohë kur në civilizimin tonë po mbizotëron kriza. Siç duket, kriza në shoqërinë bashkëkohore është intensifikuar tepër. Ajo ka filluar ta rrezikojë shoqërinë edhe përbrenda edhe nga jashtë. Ndërkaq, familja si institucion themelor dhe më i ndieshëm, me anë të një shkatërrimi të fuqishëm destruktiv ka filluar të rrënohet gjithnjë e më tepër.¹

Të gjitha këto dukuri dëshmojnë se kriza në përgjithësi ka filluar ta cenojë familjen, ndaj më së tepërmi e ka dobësuar atë, madje ajo gjendet në shkatërrim e sipër në Evropë dhe në Amerikë.²

Kjo nxiti nevojën e përpjekjeve që përsëri të rishqyrtohen bazat, mbi të cilat do të duhej të gjallërohet jeta familjare në Perëndimin modern, e po ashtu të hulumtohen edhe bazat alternative të strukturës në vendet tjera me tradita e me kultura të nduarduarta.

Kjo e nxiti njeriun bashkëkohor të njoftohet me natyrën e familjes dhe me elementet e krizës, që sot e rrezikojnë atë, duke u gjetur disa shtegdalje tjera që do ta lironin nga këto probleme aktuale.

¹ Shih. Daniel Bellin “The coming of post industrial society”, Londër 1974, Rovert L. Hilbroner “The human prospekt”, The New York of Bocks, 1974 dhe Pitrin A. Sorkin “Sosial Philosophies of an age of orisis”, Londër 1950.

² Kjo vërtetohet me shpërthimin e marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore, me shtimin e numrit të shkurorëzimeve të martesave, me thjeshtësimin e amvisërisë, me abortet dhe lindjet jashtëmartesore etj. Shih. “The marriage relationship today”, J. Dominion 1974 Vance Packard “The sexual vilderness” 1968 New York, Mayory Ritfagen “Sins of their fathers” 1068

Në këtë drejtim do të përpiqem që në faqet vijuese ta përshkruaj jetën familjare në vendet me traditë dhe me kulturë kryesisht tjetër.

Një gjë e këtu e nxitë njeriun që të njoftohet me problemet e familjes dhe me elementet e krizës, që sot e rrezikojnë atë (familjen), ndaj duhet të gjejë disa zgjidhje që do ta shkarkojnë nga këto probleme. Prandaj, në këtë aspekt do të orvatem që këtu ta përshkruaj jetën familjare në Fenë Islame si dhe themelet, strukturat dhe parimet e saj.

Që ta kuptojmë institucionin e jetës familjare islame, do të jemi në pozitë më të mirë nëse e fillojmë atë nga përshkrimi i thuktë i vështrimit për jetën, besimin dhe kulturën e saj.

TEVHIDI - NJËSIA E ZOTIT

Islami pohon: All-llahu është Një, sovraniteti i Tij në Gjithësi është i pandashëm. All-llahu është Krijues, Zotërues dhe Ushqyes i çdo gjallesë që jeton. Çdo gjë e krijuar vepron në suaza të qëllimeve të Tij. Ai përmes Të dërguarve të Tij ka treguar Rrugën e Drejtë të cilën duhet ta ndjek shoqëria njerëzore. Të gjithë Të dërguarit e Zotit publikisht i kanë predikuar të njëjtat porosi - të pranohet sovraniteti i Zotit për çdo gjë që është krijuar. Ata i ftonin burrat dhe gratë që të jetojnë në bashkësi, të veprojnë drejt e me nder, të jetojnë në qetësi dhe e tërë kjo të bëhet në pajtim me rregullat që i ka caktuar All-llahu. Të gjithë Të dërguarit e Zotit, prej h.Ademit, h.Nuhit, h.Ibrahimit e deri te h.Musa, h.Isa dhe h.Muhammedi a.s. kanë predikuar vetëm një besim, që e

kanë pranuar, e ky është që t'i nënshtrohemi vetëm All-llahut dhe t'i dorëzohemi paqes, do të thotë Islamit.³

Gabimi thelbësor i njeriut qëndron në atë se ai nuk i është nënshtuar plotësisht Të Gjithëfuqishmit dhe se nuk u është përmbajtur mësimëve të Të dërguarve të mëparshëm të Zotit. Si I Dërguari i fundit i Zotit, Muhammedi a.s. edhe një herë i ka ripërtërirë udhëzimet origjinale në format më të përsosura dhe në atë mënyrë, që fjalët e Zotit më nuk ka qenë e mundur (e as që do të jetë) të zëvendësohen me fjalë njerëzish.⁴

MËKËMBËSIA E NJERIUT

Kur Tevhidi (Njësimi i Zotit) është vendosur si bazë ideore e Islamit, termi i hilafetit të njeriut (hahfe - mëkëmbës) është caktuar në skemën e jetës islame. Tregimi për h.Ademin dhe h.Havën mund të haset në të gjitha religjionet e njohura dhe në të gjitha civilizimet tradicionale. Mirëpo, në të gjitha këto predikime janë përzier realiteti dhe imagjinata. Themeli kryesor i predikimit të

³ Shih Kur'anin 3:2; 3:84; 42:13; mandej A. Hurshid "Islami: Parimet dhe karakteristikat themelore" 1074.

⁴ Nëse ky fakt kërkohet vazhdimisht, shumë shkrimtarë do të duhej të largohen padashtas nga teoria e "plagjiatit religjioz" dhe e "huazimit" nga religjionet e mëparme, gjë që ishte temë e preferuar e disa orientalistëve.

Kur'anit është ky⁵: All-llahu me dëshirën e vet ka vendosur halife në tokë. Ai krijoi h.Ademin dhe h.Havën nga substanca e njëjtë, nga dheu. Ata ishin të caktuar të vepronjë si zëvendës, ndaj ishin të aftësuar “t'i njohin të gjitha gjërat” e nevojshme për ekzistimin e tyre. Pastaj u vunë në sprovë, edhe pse u ishte thënë se nuk guxojnë t'i qasen drurit të caktuar. Ata u bënë viktimë të bindjes së gabuar, ndaj bënë mëkatën e palejueshëm.

Mirëpo, menjëherë pas gabimit të bërë, ata e pranuan fajin dhe iu lutën All-llahut që t'ua falë atë gabim. Pasi iu fal faji, u urdhëruan të vendosen në tokë dhe aty të marrin rolin e mëkëmbësve të Zotit. Me ndihmën e tyre u përhap mësimi i Zotit, duke garantuar se nëse e përcjellin këtë mësim, do të jenë të lumtur. H.Ademi ishte njeriu i parë që pranoi udhëzimet e Zotit dhe i cili ua përcolli pasardhësve të vet.

Prandaj, nga kjo mund të nxirren përfundime shumë të rëndësishme:

1.Islami me asgjë nuk ka ndikuar që të krijohet teoria e ndonjë “vuajtjeje të h. Ademit”, që do të duhej të simbolizonte nevojën e vuajtjes së njeriut. Nuk ka kurrfarë vuajtjesh e as që këtë duhet ta kuptojmë ashtu. Njeriu është krijuar të veprojë si mëkëmbës i Zotit në Tokë, ndaj ai ka ardhur në Tokë ta kryejë këtë mision. Ky funksion paraqet madhësitinë e njeriut në Shpalljen e Zotit, duke e paraqitur fatin e tij e kurrsesi vuajtjen.

⁵ Tregimi për këtë gjendet në Kur'an në shtatë vende: 2/122-123; 7/11-24; 15/26-42; 17/61-65; 18/50-53; 20/122-123; 38/71-83. Shih edhe Muhammed Ikbāl, “The Reconstruction of Religious Thought in Islam”, Lahore, Sh. M. Ashraf, 1971, f.82-88 dhe Abdul A'la el Mevdudi, “Tefhimu-1-Qur'an”, Lahore, Mektebi Ta'mire Insanijet, 1973, f.61-70 nga bot. I dhe 10-20 nga bot. II.

2. Roli dhe pozita e mëkëmbësit është nder që e ngrit njeriun nga fillimet e para, dhe ky rol i caktuar është me rëndësi si për burrin ashtu edhe për gruan. Në këtë qëndron edhe rëndësia e barazisë së tyre si qenie njerëzore, si mëkëmbës të Zotit në tokë dhe çdonjëri prej tyre e ka rolin e vet në shoqëri.

3. Islami nuk pranon teorinë se gruaja e ka bindur burrin (dmth. h.Hava e ka bindur h.Ademin) që ai të gabojë dhe të bëhet i padëgjueshëm. Në pajtim me tekstin kur'anor: “Djalli i ka shtyrë që të dy të largohen nga urdhri i Zotit “. Që të dy janë fajtorë për veprën e bërë, që të dy e kanë pranuar fajin dhe që të dyve u është falur. Ata janë dërguar në botë pa kurrfarë njolle dhe pa të ashtuquajturin “mëkat i parë” në shpirtin e tyre.

4. Njeriut i është ofruar liria e zgjedhjes. Ai është i lirë ta pranojë ose ta mohojë të vërtetën. Ai është përgjegjës për veprimin e tij, por nuk mund t'i kufizohet liria edhe nëse gabon me qëllim.

Rëndësia e pozitës së njeriut qëndron në kërkimin e tij psikosocial, që para së gjithash del nga potenciali i njeriut, të ngrihet në pozitën më të lartë⁶ ose të rrokulliset në abisin më të thellë.⁷

5. Rreziku nga keqpërdorimi i lirisë shihet në synimin e përhershëm të njeriut që t'i kundërvihet çdo gjëje, që i paraqitet si pengesë gjatë karrierës së tij në këtë botë. Kërcënimi nga ana e djallit është i përhershëm. Shpëtimi i njeriut është përpjekja dhe kundërvënia e tij kundër djallit, si dhe strehimi i tij nën sundimin e Zotit. Përvoja e h.Ademit dhe h.Havës na tregon fisnikërinë dhe

⁶ Shih Kur'anin 95:4

⁷ Shih Kur'anin 95:5,6; 103:2,3

pastërtinë e nevojshme të natyrës së tyre dhe nevojën për pendimin për fajin e bërë. Kjo dëshmon nevojën e udhëheqjes së Zotit ndaj njeriut.

6. Njeriu nuk është plotësisht imun ndaj gabimeve. Kjo do të mund të kishte pasoja negative në lirinë e zgjedhjes. Ai do të mund të gabojë dhe shpëtimi i tij qëndron në eliminimin e atyre gabimeve, në kërkimin e faljes për gabimet eventualisht të bëra dhe kthimin në Rrugën e Drejtë (Sirati Mustekim). Teoria e halifit është dëshmuar me krijimtarinë e qëllimtë të All-llahut,⁸ e kurrsesi me paraqitjen e rastësishme të njeriut në Tokë. Njeriu është krijuar me qëllim të caktuar. Të gjitha gjërat tjera janë krijuar si mjete që t'i shërbejnë njeriut. Rruga e tij jetësore fillon me mision të vetëdijshëm, e jo me vendnumërimin në errësirë. Përsosuria e njeriut është vendosur para se ai ta pranojë Shpalljen e Zotit. Mundësitë për suksese në zhvillimin e mëtejshëm të njeriut qëndronin para tij.

Shpallja e mrekullueshme e Rrugës së Drejtë është projektuar qartë.

Jeta e njeriut në Tokë është në përfitimin e përvojës së natyrshme. Ky ishte hapërim kohor. Një zhvillim i këtyre paraqet udhëtimin drejt jetës së amshueshme, ku njeriu do t'i korrrë frytet për veprat e tij gjatë jetës së vet në Tokë. Në këtë sprovë të përjetshme, burri dhe gruaja participojnë njësoj, marrin njësoj, ndaj edhe korrrja e fryteve do të jetë e njëjtë për të dy, dënimi ose dhurata. Asnjëri prej tyre nuk do ta fajësojë tjetrin, sepse që të dy kanë bashkëjetuar.

Kur'ani thekson qartë se gruas dhe burrit do t'u takojë dhe do të fitojnë aq sa janë munduar. E kjo do të jetë si masë e fundit për shkallën e suksesit të arritur të tyre.

⁸ Shih Kur'anin 6:165

“Dhe besimtarët, burrat dhe gratë, janë mbrojtës dhe miq të njëri-tjetrit; ata urdhërojnë të mirën, kurse ndalojnë të keqen; kryejnë faljen, japin zeqat dhe janë të dëgjueshëm ndaj Zotit dhe Të dërguarve të tij. Këta do ta shijojnë mëshirën e All-llahut. All-llahu u ka premtuar besimtarëve, burrave dhe grave, kopshte ku rrjedhin lumenj, e ku do të kalojnë jetë të amshueshme. Ky pushim në kopshtet e xhennetit është më i mrekullueshëm se çdo gjë tjetër. Kënaqësia e Zotit është mbi ta. Ky është suksesi më i madh.”⁹

“Ai që bën vepër të mirë, burri ose gruaja, dhe është besimtar, Ne do t’ia mundësojmë të jetojë jetë të mirë dhe në të vërtetë Ne do t’i shpërblejmë për veprat më të mira që i kanë kryer.”¹⁰

“Burrat dhe gratë që i dorëzohen All-llahut, burrat dhe gratë që besojnë, burrat dhe gratë që janë të dëgjueshëm, njerëzit që janë të qëndrueshëm (në drejtësi dhe në sinqeritet), burrat dhe gratë që janë të përmbajtur, burrat dhe gratë që ndajnë mëshirë, burrat dhe gratë që janë stabilë, burrat që janë të sjellshëm dhe modestë e po ashtu dhe gratë që janë të sjellshme dhe modeste, burrat dhe gratë që e kujtojnë shpesh All-llahun, All-llahu është më i mëshirshëm që t’ua falë gabimet e rastësishme dhe do t’i shpërblejë më së miri”.¹¹

Kështu Kur’ani përshkruan sgebullin ideal të burrit dhe të gruas dhe rrugën që duhet ndjekur në këtë botë, që të jenë të gatshëm ta presin Ditën e Gjykimit. Me këtë hollësisht është theksuar

⁹ Shih Kur’anin 9:71-72

¹⁰ Shih Kur’anin 16:97

¹¹ Shih Kur’anin 2:207

se çfarë i pret njerëzit e tillë, të cilët në mënyrë besnike i kryejnë amanetet e Zotit. Në këtë qëndrojnë themelet e barazisë së burrave dhe të grave dhe roli i tyre në këtë botë.

RRUGA E PËRSOSUR NË JETË

Islami vërteton sovranitetin e Zotit mbi të gjitha ndodhitë në jetën e njeriut. Ai, për ta shpëtuar shpirtin, mohon asketizmin dhe besimin e shkatërrimit të jetës. Islami e afirmon jetën dhe plotësimin e kërkesave jetësore, kurse hedh poshtë ndarjen në mënyrë shpirtërore dhe hyjnore të jetesës, në mënyrë të kushtëzuar dhe laike. Është e domosdoshme që njeriu të inkurajohet që plotësisht të bashkëveprojë në Besimin islam dhe që ta nderojë jetën në të cilën ballafaqohet shpirtërorja, që e orienton edhe e përbotshmja, që e kthen nga rruga e paditurisë në rrugën e drejtë.¹² Kjo ofron tërësinë e qëllimit jetësor dhe realitetin e tij. Mësimi islam përmban në vete të gjitha fushat e aktivitetit njerëzor, si ato shpirtërore po ashtu edhe ato materiale, personale dhe shoqërore, arsimore-kulturore, ekonomike-juridikeshoqërore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Islami kujdeset për aspiratat shpirtërore, e po ashtu edhe për kërkesat e institucioneve shoqërore dhe juridike. Përsosuria islame synon drejt shembullit frymëzues të jetës së gjithmbarshme. Çdo aktivitet që i dedikohet kujtdo qoftë, transanksionit ekonomik, marrëdhënieve seksuale, veprimtarisë diplomatike, eksperimenteve shkencore etj., janë identike me lutjet nëse ato kryhen me vetëdije e në emër të All-llahut dhe në pajtim me vlerat dhe parimet e Shpalljes së Tij, kurse

¹² Shih Kur'anin 2:207

janë të pavlefshme nëse shpallen në emër të diçkaje apo të dikujt tjetër. Raporti aktiv ndaj përmbajtjes ekonomike, juridike-shoqërore, ligjore dhe seksuale, si dhe sjelljes shoqërore, është pjesë e përvetësimit të besimit të njeriut dhe nuk mund të jetë në dëm të qëllimit të tij. Jeta organikisht është e pandashme dhe me parime të pandryshueshme, ndaj, sipas kësaj udhëhiqet dhe përkufizohet. Sheriati është kod islam, që e rregullon jetën në tërësinë e saj. Shembulli i Të Dërguarit të Zotit, Muhammedit a.s., është model që muslimanët të përpiqen ta ndjekin, ndërsa shembulli i tij jetësor është i vetmi që duhet marrë si udhërrëfyes në të gjitha aspektet e jetës njerëzore, që Muhammedin a.s. e ngriti në shkallën e personalitetit më të lartë, plotësisht shoqëror - si njeri, bir, burrë, baba, predikues, mësues, tregtar, shtetar, udhëheqës ushtarak, shpirt i qetë e pajtues, dhe gjykatës.

Islami si fe ka kuptim revolucionar në jetë. Ai në marrëdhënie të rëndomta i jep forcë të re çfarëdo lëvizjeje. Çdo vepër fetare është qëndrim, që ndërmerret dhe harmonizohet me vlerat e vendosura nga All-llahu dhe Pejgamberi i Tij. Me këtë kuptim revolucionar, aspekti i plotë jetësor është arritja e pozitës më të lartë të All-llahu dhe pajtueshmëria më e lartë tek Ai. Asgjë s'është paraparë që të arrihet mbështetja e Qesarit.¹³

¹³ Qasja e këtyllë ndaj jetës më së miri dhe shkurtimisht është përmbledhur në lutjen që lexohet nga Kur'ani dhe është njëra nga lutjet më të theksuara në Islam: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr! “ (Kur’ani, 2:201) I Dërguari i All-llahut xh.sh. ka thënë: “Erërat (aromat) dhe gratë më bëjnë të butë, ndërsa kënaqësia për sytë e mi gjendet në lutje (namaz)” . Koncepti i përmbledhur i besimit përpiqet që të vendosë lidhje ndërmjet dy kategorive të paraqitura në erën e këndshme të gruas nga njëra anë, dhe lutjes (namazit) nga ana tjetër. Mirëpo, I Dërguari i All-llahut i ka vendosur të dyja dhe në tërësi ia ka nënshtruar sovranitetit të All-llahut xh.sh.

BESIMI - THEMEL I SHOQËRISË

Islami besimin dhe faljen i shpalli si themele të përgjithshme të shoqërisë humane dhe si faktor për zhvillimin e marrëdhënieve të tij. Të gjitha dallimet në bashkësitë dhe grupet shoqërore që bazohen në racë, në prejardhje, në fis, në pozitë gjeografike etj., për shkak të mënyrës së re të organizimit që buron nga besimi, janë të parëndësishme për Islamin. Pranimi i Islamit për njeriun nuk do të thotë pranim vetëm i Zotit, por nënkupton edhe integrimin e tij të plotë në bashkësinë e besimtarëve. Ky qëndrim ndaj Zotit dhe ndaj bashkësisë zhvillohet vetëm me anë të besimit. Koncepti islam ndaj bashkëjetesës nuk bazohet në racë, në gjuhë, në ngjyrë, në territor e në favorin ekonomik-politik. Bashkësia islame është vëllazëri njerëzish e bazuar në besim, - çdo individ që e ka pranuar Islamin dhe besimin e tij, është pjesë e pandashme e asaj bashkësie pa dallim race, ngjyre, gjuhe ose vendlindjeje. Këto janë parime plotësisht të reja të organizatës humane, që i janë përshtatur natyrës njerëzore dhe janë të afta ta përfshijnë gjininë njerëzore në tërësi. Ky koncept i ndërtimit të një mori idealesh dhe mendimesh të bashkësisë, nuk është rregull i rastësishëm moral; ky koncept është koncept i dimensioneve të shoqërisë juridike-ligjore. Ai është prodhim i strukturës së mëtejme për marrëdhënie njerëzore. Besimi është forcë vendimtare në këtë sistem. Ajo krijon institucione shoqërore, duke filluar që nga jeta familjare deri te bashkësia e organizuar dhe plotësisht e sistemuar. Civilizimi islam zhvillohet duke filluar nga besimi, njësoj siç zhvillohet edhe druri nga fara. Që të shfrytëzohen forcat e jashtme dhe

Si të tilla, namazi dhe progresi botëror nuk paraqesin dy kategori në Islam: ato janë të bashkuar në një tërësi të plotë. Namazi paraqet njërin nga themelet e progresit shoqëror, ndërsa progresi pa namaz është kthim prapa.

potenciali i forcës vendimtare, madhësisë së zhvillimit i kontribuon favorizimi që e plotëson këtë detyrë. Shoqëria islame dhe civilizimi i këtillë janë tërësi idealesh dhe mendimesh universale në origjinalitetin dhe në orientimin e saj. Këto fakte, besoj se do të ndihmojnë në të kuptuarit e natyrës së sistemit islam për jetën. Civilizimi islam nuk mund të kuptohet nëse disa pjesë të tij studiohen të izoluara ose në vështrimin e civilizimit të bazuar në themele diametralisht të ndryshme nga vlerat e tij reale. Institucionin familjar islam po ashtu duhet studiuar në frymën e kulturës islame dhe duhet hulumtuar në perspektivën e pikëpamjeve islame ndaj jetës.

II. FAMILJA NË ISLAM PARIMET THEMELORE

Tani jemi në pozitë që në mënyrë të qartë dhe të plotë t'i vështrojmë parimet thelbësore, që vërtetojnë intucionin natyror të familjes në Islam, që përcaktojnë vendin e saj dhe që mbrojnë rregullimin e saj në shoqërinë islame.

INSTITUCION HYJNISHT I FRYMËZUAR

Familja është institucion i caktuar i frymëzimit hyjnor. Ajo nuk është zhvilluar nëpërmjet proceseve eksperimentale të evolucionit njerëzor e as rastësisht gjatë rrjedhës së kohës. Ajo është

krijuar si institucion i mënyrës së jetës, që t’i mundësojë njeriut punë krijuese. Raca njerëzore është prodhim i këtij institucioni, e nuk është institucioni prodhim i racës njerëzore. Kur’ani lidhur me këtë thotë: “O njerëz, bëhuni respektues të bindur të Zotit tuaj, i cili ju krijoi prej një individi, kurse prej tij krijoi gruan, e ndërsa prej tyre krijoi dhe shpërndau shumë burra e gra dhe bëhuni të kujdesshëm në obligimin tuaj ndaj All-llahut, në emër të të cilit ju i drejtoheni njëri-tjetrit të bashkuar në një krah. Vërtet, All-llahu është Mbikëqyrësi juaj”.¹⁴

Në një vend tjetër të Kur’anit, krijimi i burrit dhe i gruas dhe marrëdhëniet e tyre bashkëshortore në harmoni, dashuri dhe qetësi janë përshkruar si “shenjë e Zotit”.¹⁵ Institucioni i martesës dhe i familjes konsiderohet si porosi dhe si orientim i Të Dërguarit të Zotit.¹⁶ I Dërguari i Zotit thotë: “Martesa është pjesë e Sunnetit tim, ai që largohet nga rruga ime, nuk është yni.”¹⁷

¹⁴ Shih Kur’anin 4:1. Kjo në këtë version do të mund të ishte shënuar si institucion i familjes së parë të h. Ademit dhe h. Havës, e pasqyruar si shtytëse kryesore e racës njerëzore. Ky është gjithashtu edhe kuptimi i foljes veteku (bëhuni respektues të bindur), e përdorur me këtë rast për respektimin e All-llahut xh.sh., e gjithashtu edhe për el-erham (prehër-mitra, marrëdhënie logjike e farefisnisë më të afërt).

¹⁵ Shih Kur’anin 30:21.

¹⁶ Shih Kur’ani 13:38: “Ne kemi dërguar peygamberë edhe para teje, o Muhammed. Ne u kemi caktuar atyre bashkëshorte dhe fëmijë (trashëgimtarë)”.

¹⁷ Ibni Maxhe, “Sunnan”, Libri për kurorëzimin.

MARRËVESHJA SHOQËRORE

Meqë martesë është institucion i urdhëruar nga Zoti, çdo martesë si e këtillë natyrisht se është marrëveshje ndërmjet dy gjinive të kundërta.

Fjala “ nikah” edhe në Kur’an edhe në Sunnet përdoret për kurorëzim dhe nënkupton “akd” dmth. marrëveshjen. Në Kur’an martesë nënkuptohet si marrëveshje e fortë. Praktika paraislame që edhe gruaja të trashëgohet, me ardhjen e Islamit u ndalua. Pajtimi i të dyve, i burrit dhe gruas, është një nga kushtet e theksuara për vlerën e kurorëzimit në Islam.

Me këtë dëshirohet të theksohet se kurorëzimi është marrëveshje shoqërore, e lartësuar dhe solemne, por megjithatë është marrëveshje. Nëpërmjet kësaj nënkuptohen një varg marrëdhëniesh, që janë përshkruar në sistemin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella. Kjo marrëveshje, megjithatë, nuk është as sakrament e as e pakundërshtueshme. Ndarja është e mundshme në rastet kur bashkëshortësia është e dështuar. Nuk ka turp përballë dëshirës për kurorëzim ose martesë të sërishme, si për burrin vejan ashtu edhe për gruan e ndarë e të vejë.

FEJA DHE FAMILJA

Feja përcakton themele të forta për institucionin e familjes. Muslimanit apo muslimanes nuk i lejohet që të martohet me politeistë (mushrikë) dhe jomuslimanë.¹⁸

Martesa duhet të lidhet ndërmjet individëve që kanë pikëpamje të njëjta për jetën dhe moralin dhe që plotësisht veprojnë në frymën e urdhrave të Zotit. Në realitet, ajo është shprehur edhe me qëndrimin parimor për martesën ku vlen rregulla: “Gratë e shëmtuara martohen për burra të shëmtuar, kurse burrat e shëmtuar për gra të shëmtuara “, kurse “gratë e ndershme me burra të ndershëm dhe burrat e ndershëm me gra të ndershme “,¹⁹ “pushti nuk mund të martohet me asnjë grua tjetër, përveç me laviren dhe anasjelltas”.²⁰

Besimi nuk pushon të luajë rolin vendimtar në sistemin e gjithmbarshëm të marrëdhënieve familjare. Biri musliman nuk mund ta trashëgojë babain jomusliman, por edhe babai musliman nuk mund ta trashëgojë pasurinë e djalit jomusliman. Po ashtu, nëse njëra palë gjatë jetës bashkëshortore e ndërron fenë, marrëveshja bashkëshortore konsiderohet e shfuqizuar.²¹ Prandaj, marrëdhënia martesore nuk është formë e thjeshtë e marrëdhënieve seksuale, ajo është bazë e ekzistencës shoqërore fetare.

¹⁸ Ragib el Isfahani, “Mufradatul Kur’an”.

¹⁹ Shih Kur’anin 4:21

²⁰ Shih Kur’anin 4:19: “O ju që besuat, nuk është e lejuar për ju të trashëgoni gratë (e të vdekurve) në mënyrë të dhunshme...”

²¹ Shih Buhariu, “Libri për Nikahun”. Shih Kur’anin 2:232.

MARTESA

Islami e rekomandon martesën dhe është e ndaluar çdo formë e marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore. Po të dëshmohet se ka marrëdhënie të dëfrimit të përkohshëm, një gjë e tillë jo që është e ndaluar, por edhe dënohet me rregulla islame. Rregullat islame kërkojnë që dëfrimi të bëhet në bashkëshortësi, sepse kështu të dy bashkëshortët marrin përgjegjësi të njëjtë për një dominim stabil në shoqëri. Kjo duhet të jetë forma elementare e lidhjes martesore dhe e stabilitetit të jetës familjare. Marrëdhëniet e ndërsjella nuk janë diç e përkohshme dhe kalimtare, përkundrazi, ato janë dhe duhet të jenë të përhershme, sepse nga marrëdhëniet e përkohshme rrjedhin pasoja të dëmshme për shoqërinë, ndërsa martesë është diç tejet serioze dhe e pranuar prej të dy palëve, që kërkon tolerancë dhe përpjekje që të jetohet në bashkësi dhe t'i kontribuohet shoqërisë.

Institucioni i familjes ka rol të rëndësishëm në shoqërinë islame. Ajo është njësia themelore në atë shoqëri dhe është e organizuar në atë mënyrë që të veprojë si bashkësi në miniaturë. Përafërsisht një e treta e AHKAMIT (rregullat juridike të Kur'anit) kanë të bëjnë me familjen dhe me rregullimin e harmonisë së saj. Është një gërshetim i tërë i të drejtave dhe obligimeve, që i sigurojnë themelet e jetës familjare të orientuar me kontributin e këtyre raporteve dhe sjelljes ndaj shembullit të caktuar, me çka Islami dëshiron ta mbrojë individin apo shoqërinë.

Vendosja e baraspeshës ndërmjet burrave dhe grave është e rëndësishme në ekzistimin e marrëdhënieve të ndërsjella të tyre, ndërmjet të rinjve dhe pleqve, ndërmjet farefisit të afërm dhe të largët, ndërmjet të drejtave të përjetimit të lirë dhe disiplinës, ndërmjet mençurisë së individit dhe kontrollit shoqëror.

Familja muslimane, sa u përket marrëdhënieve dhe obligimeve, dallon dukshëm në krahasim me familjet tjera jomuslimane. Ajo nuk është familje nukleare e organizuar vetëm nga prindërit dhe fëmijët, por është më e gjerë dhe nën kulmin e vet përfshinë tri ose katër gjenerata. Vështirimi i kujdesshëm për të drejtën e trashëgimit, tregon se të gjitha marrëdhëniet janë pjesë integrale e strukturës familjare e jo diç periferike në të.

BARAZIA NDËRMJET GJINIVE

Islami vë në dukje barazinë ndërmjet burrit dhe gruas si qenie njerëzore. Kjo barazi nuk ndikon në dallimin e roleve dhe funksioneve të tyre individuale në shoqëri. Islami nuk lejon liri të plotë dhe të pakufizuar të përzierjes së gjinive dhe këtë e shikon si kundërshti ndaj rolit që i është caktuar në familje e në jetë. Përgjegjësia parësore e gruas është që tërë kujdesin t'ia kushtojë amvisërisë dhe familjes dhe gjithçka që kërkon operativitet dhe zhvillim të këtij institucioni. Gruaja ka përgjegjësi shoqërore ndaj familjes, sepse e drejta dhe obligimi familjar është kujdesi i saj kryesor. Ky është qëllimi i ndarjes së roleve të aktiviteteve dhe raporteve të rëndësishme për një veprim harmonik, duke marrë parasysh lëmenjtë e ndryshëm në shoqëri si dhe për një ekzistencë të plotë dhe moral të shëndoshë të familjes. Përgjegjësia për të ekonomizuar dhe për të mbajtur familjen, banimi e strehimi, i mbeten plotësisht burrit, i cili, duke vepruar optimalisht në shtëpi dhe duke i pasuruar marrëdhëniet në familje, bashkë me bashkëshorten kujdeset paralelisht edhe për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve.

III. FAMILJA DETYRAT DHE QËLLIMET E SAJ

Si duhet vepruar në familjen, që Islami dëshiron ta konstitujë për ta plotësuar ajo detyrën e saj në jetën e individit dhe të shoqërisë? Familja nuk është fabrikë për shtimin e gjinisë njerëzore. Familja në përgjithësi, edhe pse mbajtja, degëzimi dhe shtimi i sojit të njeriut janë ndër qëllimet e saj kryesore, ka strukturë shoqërore-kulturore dhe luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e mekanizmit për të siguruar stabilitet shoqëror, ideor dhe kulturor në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë. Kështu ishte në të kaluarën, kështu është edhe sot, e kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Të fillojmë nga qëndrimet e përgjithshme të shkruara për rolin e vërtetë të familjes, siç thuhet në Kur'an dhe në Sunnet.

A. RUAJTJA DHE VAZHDIMËSIA E RACËS NJERËZORE

Ruajtja e racës njerëzore, e civilizimit dhe e vazhdimësisë së saj në funksion të njeriut si mëkëmbës i Zotit, varet nga operativiteti i mekanizmit për lindje dhe shtim. Natyra është e përgatitur për gjëra të këtilla, ku dallimi psikologjik dhe fiziologjik ndërmjet gjinive plotëson njëri-tjetrën. Vazhdimësia e racës në procesin e vet kërkon strukturë stabile, që vepron në mënyrë të organizuar. Burri, gruaja dhe fëmijët kanë nevojë të përhershme për vendosjen e rregullimit që

do ta përmbush këtë funksion. Pikërisht familja është institucion që mund ta plotësojë këtë proces që nga fillimi i zhvillimit e deri në përsosje. Kur’ani thotë:

“O njerëz, jini të vetëdijshëm dhe besnikë ndaj Zotit, që ju krijoi prej një njeriu, ua krijoi prej natyrës së njëjtë njerëzore shoqen dhe prej këtyre dyve krijoi dhe përhapi shumë burra dhe gra ...”

“Gratë tuaja janë si arat për punim, ndaj qasjuni arave tuaja kujdesshëm dhe kujdesuni për atë që është juaja, dhe jini të vetëdijshëm dhe besnikë ndaj Zotit, dini se do të takoheni me Të.”²²

B. MBROJTJA E MORALIT

Epshi seksual është gjë e natyrshme që është krijuar si çytje. Edhe pse kjo është cilësi e përbashkët për të gjitha qeniet e gjalla, te burri dhe gruaja ekzistojnë disa aspekte specifike. Te qeniet tjera më me rëndësi është lindja, që rregullohet me anë të instinktit dhe ky është proces natyror. Ato nuk janë të afta për sendërtimin e atyre nxitjeve epshore në çdo kohë, por këto nxitje te ato paraqiten në intervale sezonale ose gjatë ndonjë cikli të caktuar.

Ndërkaq, te gjinia njerëzore nuk kemi të bëjmë me raste të këtilla. Shtytja epshore tek njeriu ekziston përherë, duke i munguar mekanizmi i sendërtuar psikologjik për kontroll. Mirëpo, kontrolli dhe rregullimi janë shumë të rëndësishëm për ekzistencë të shëndoshë, e po ashtu edhe për

²² Shih Kur’anin 2:223

orientim biologjik. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme për arsye të drejtimit të zhvillimit kulturor-shoqëror. Rruga e ndërmjetme, që nuk është as abstenim i plotë as rrëmujë e vazhdueshme, mund të shpie në ekzistencë të shëndoshë dhe stabile. Islami i ndalon marrëdhëniet jashtëmartesore në të gjitha format e tyre. Prandaj, duke shkuar në hap me jetën urdhëron bashkësinë martesore, e cila u ofron burrave dhe grave mundësi që shtytjet e tyre natyrore t'i plotësojnë në të gjitha format e jetës, e cila u ofron kënaqësi, por edhe përgjegjësi. Marrëdhëniet seksuale nëpërmjet bashkësisë martesore janë i vetmi mekanizëm që siguron kontrollin e plotë në ngatërresat seksuale. Martesa gjithashtu është edhe një ventil sigurimi për moral seksual. Me anë të martesës kryhet dhe thellohet rruga e baraspeshës në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Kur'ani martesën e quan HISN - kështjellë për mbrojtje nga mënyra e shfrenuar e jetës, dhe thotë:

“Kurorëzohuni me lejen e prindërve të tyre dhe jepni dhuratat tuaja me mirësjellje, si grave që kanë dinjitet të vetin, e jo si atyre të pamoralshme dhe atyre që sillen shfrenueshëm.”²³

Në një vend tjetër njeriu udhëzohet që:

“Ju lejohet të keni gra të ndershme, besnike dhe modeste, gra të cilave u është dhënë Libri para jush. Kur t'ua dhuroni dhuratat e martesës dhe të jetoni me to, mos bëni gjëra imorale me to e as mos bëni dashuri të shfrenuar”.²⁴

²³ Kur'ani 4:25

²⁴ Kur'ani 5:5

C. STABILITETI PSIKO-EMOCIONAL, DASHURIA DHE MIRËSJELLJA

Qëllimi i dytë i martesës është që të kultivohet miqësia psiko-emotive dhe shpirtërore. Marrëdhëniet në familje, ndërmjet të gjithë anëtarëve të saj, janë faktori më i rëndësishëm, veçanërisht ndërmjet burrit dhe gruas, por jo si marrëdhënie të nxitura nga interesi. Ato duhet të jenë marrëdhënie shpirtërore, ndarje e përbashkët e së mirës dhe së keqes, marrëdhënie që kultivojnë dashuri, mirësjellje, mëshirë, miqësi, besim të ndërsjellë, sakrifikim, ngushëllim dhe ndihmë në momentet vendimtare të jetës. Prandaj, në natyrën njerëzore është mirë që të kultivohen marrëdhënie të këtylla familjare. Vetëm në kuadër të familjes potenciali shpirtëror i burrit dhe i gruas bëhet realitet dhe zhvillon pastërtinë morale brenda dhe jashtë familjes, do të thotë edhe në shoqëri. Në martesë miqësia kërkon prej çdonjërit gjithnjë e më shumë plotësim të dëshirave. Vlera e bashkëndjnjave në familjet me fëmijë kërkon dashuri dhe mëshirë, sakrifikim të njërit për tjetrin, tolerancë dhe dashuri për të formuar karakter të fortë të anëtarët e familjes. Kjo është familja që siguron klimë të përshtatshme për zhvillimin dhe kultivimin e karakteristikave të veçanta njerëzore. Prandaj familja është, siç ka thënë I Dërguari i Zotit, vendi më i mirë në botë. Funkzioni i familjes dhe i martesës është trajtuar në shumë vende të Kur'anit, ku thuhet:

“Dhe njëra prej shenjave të Tij është se Ai për ju i krijoi gratë që të mund të pushoni pranë tyre dhe të gjeni prehje dhe qetësi në to, dhe Ai vendosi ndërmjet jush dashurinë dhe mëshirën.”²⁵

²⁵ Kur'ani 30:21. Fjala kur'anore “sekine” i përfshinë të gjitha këto nuanca kuptimore, madje edhe shumë më gjerë.

Në një vend tjetër raporti ndërmjet bashkëshortëve është përshkruar si raport i afrisë ndërmjet “trupit dhe rrobave”:

“Ato janë si rrobat tuaja kurse ju jeni si rrobat e tyre.”²⁶ Ky theksim i identitetit dhe veçantisë së tyre është diç më i lartë se barazia ligjore. Burri dhe gruaja përshkruhen si rroba për njëri-tjetrin, e jo që njëri të jetë trup, kurse tjetri rrobë. Rrobat janë diçka shumë e afërt për trupin e njeriut, ato janë pjesë e botës së dukshme, janë pjesë e pandashme e qenies sonë. E këtillë është afërsia e marrëdhënieve bashkëshortore. Fustani është diçka që e mbulon dhe e mbron trupin, ndërsa bashkëshortët janë mbrojtës të ndërsjellë dhe rojtarë vigjilentë të njëri-tjetrit. Rrobat e kënaqin atë që i vesh. Njeriu pa veshje ndjen mungesë fizike. Burri dhe gruaja e plotësojnë njëri-tjetrin, njëri e përsos, e plotëson dhe e bën të lumtur tjetrin. Një raport i këtillë e mbron moralin. Pa të, njeriut i kërcënohet rreziku i humbjes dhe i sjelljes jasht normave ligjore. Të gjitha këto aspekte përfshihen me porosinë e thjeshtë, por thelbësore:

“Ju jeni rrobat e njëri-tjetrit”.

ç. Shoqërorizimi dhe orientimi i vlerave

Funksioni i shtimit në botë pa gjininë tjetër (babain), arsimimi dhe edukimi i fëmijëve, shkollimi i tyre, orientimi jetësor, formimi i karakterit, ndikimi gradual i kulturës dhe i besimit do të mbeteshin të mangët dhe jo të plotë. Kjo është kështu për arsye se ky aspekt i familjes mbetet kujdes i prindërve deri në moshën madhore të fëmijës. Kurrfarë institucioni tjetër, qofshin edhe

²⁶ Kur’ani 2:187

disa institucione, nuk do të mund të ndërmerren një kujdes të këtillë për këtë funksion- edukimin e fëmijës.²⁷

“...dhe jini të vetëdijshëm e të përkushtuar Zotit, me emrin e të cilit ju i kërkonit të drejtat tuaja dhe ruajini lidhjet farefisnore.”²⁸

T’i përkushtohesh vetëdijshëm All-llahut lidhur me farefisnin, nënkupton të merren parasysh obligimet ndaj gruas, fëmijëve dhe pjesës tjetër të farefisnit e familjes, e çfarë kujdesi duhet treguar, është theksuar në suren “Bekare”: Njëra prej rregullave e thekson kujdesin, si për veten ashtu edhe për anëtarët e familjes: “O ju që besoni”,- thuhet në Kur’an,- “përpiquni ta mbronit veten dhe anëtarët e familjeve tuaja prej zjarrit”.²⁹

Nga ky aspekt dalin edhe format reale për t’u drejtuar kah Zoti në shumë vende:

“Zoti ynë, na siguro kënaqësi neve, grave dhe pasardhësve tanë dhe na jep tërë përzemërsinë, por në vend të parë respektimin “.³⁰ “Zoti im, më mundëso t’i kryej lutjet dhe m’i bën pasardhësit e mi besimtarë. Zoti ynë, pranoje lutjen time...”

Zoti ynë, më falë mua dhe prindërit e mi...”³¹

²⁷ Është botëkuptim i gabuar se kujdestarja, çerdhja, shkolla dhe vendi i punës, që zbatohen në shoqërinë moderne, mund të bëhen zëvendësim i plotë i edukatës familjare.

²⁸ Kur’ani 4:1

²⁹ Kur’ani 2:23

³⁰ Kur’ani 66:6

³¹ Kur’ani 25:74

Për rolin e familjes, si bartëse themelore e shoqërisë, na udhëzon edhe I Dërguari i Zotit në hadithet e shumta, ku ai thotë se çdo foshnje e lindur, lind në Islam, por prindërit e saj mund ta transformojnë atë në besim tjetër ose në pabesim.³²

I Dërguari i Zotit ka thënë:

“Çdo baba mund t’i japë fëmijës së vet mësimin dhe arsimimin më të mirë”.³³ “Çdokush që i furnizon tri vajza apo tri motra dhe u jep arsimim dhe edukim të mirë dhe sillet mirë me to, Zoti do t’i ndihmojë që ai të forcohet në këmbë të veta dhe me ndihmën e mëshirës së Zotit të fitojë vendin në xhennet.”³⁴

Meqë përgjegjësia kryesore për edukimin e fëmijëve, vëllezërve më të rinj dhe motrave më të reja është obligim i familjes, ajo në rrethana të ndryshme ka detyra të shumta edhe ndaj anëtarëve më të afërt dhe më të largët. Kujdesi për prindërit dhe për anëtarët e pafuqishëm e të varfër, është paraparë edhe me Kur’an edhe me Sunnet.

³² Shih Ibni Hanbeli lib. 2, f. 315 dhe 316. Libri për interpretimin e sures „Nur”, e edhe Muslimin (Libri mbi fatin).

³³ Shih Muskatën, Libri 3, f. 716

³⁴ Shih Muskatën, Libri 3, f. 716

D. SIGURIMI SHOQËROR DHE EKONOMIK

Familja është pjesë e rëndësishme e sigurimit shoqëror-ekonomik të sistemit islam. Drejtësia vendos raportet ndërmjet vlerave morale, kulturore dhe ideore, duke shtuar edhe drejtësinë ekonomike-shoqërore ndërmjet anëtarëve të familjes.

I Dërguari i Zotit thotë:

“Kur ju dhuron Zoti begati, shpenzone atë për vete dhe për familjen tuaj”. Mbajtja e familjes është detyrë ligjore e burrit, madje edhe atëherë kur gruaja është e pasur. Ndihma për të afërmit është e urdhëruar me rregulla të veçanta. Të afërmit e varfër kanë të drejtë në radhë të parë në zekat dhe në kontribute të tjera, që janë të detyruar t’i japin anëtarët e pasur të familjes. E drejta e trashëgimisë i rregullon obligimet ekonomike brenda strukturës familjare. Këto obligime materiale shtrihen edhe në farefisën e afërm dhe të largët. Në radhë të parë prindërit tanë dhe prindërit e prindërve tanë (gjyshi e gjyshja), farefisi i babës dhe farefisi i nënës kanë të drejtë në një pjesë të pasurisë dhe të të ardhurave. Në një rast një njeri i tha Të Dërguarit të Zotit: “ Unë kam pasuri, kurse babai im ka nevojë për të”. I Dërguari i Zotit iu përgjigj: “Ti dhe prona jote i takoni babait tënd. Fëmijët janë ndër gjërat më të bukura. Kënaqu me atë që kanë arritur fëmijët tu”.

Ekzistojnë hadithe që theksojnë të drejtën e tezeve, gruas së dajës, gruas së mixhës, mixhallarëve, dajallarëve e të tjerëve. Fëmijët e adoptuar bonjakë duhet trajtuar si fëmijën tuaj. Anëtarët më të vjetër të familjes duhet nderuar, e duhet sjellur me kujdes e fisnikëri, dashuri e respekt ndaj tyre. Gjithashtu duhet sjellur me përgjegjësi ndaj fëmijëve dhe nipave. Qëndrim përgjegjës duhet pasur edhe ndaj anëtarëve të familjes së bashkëshortit ose bashkëshortes. Njëri prej faktorëve të

bashkësisë martesore dhe familjes i zgjeron obligimet edhe ndaj farefisit dhe lidhjes së tij në sistemin e përgjithshëm të sigurimit material, ndaj edhe varësia e ndërsjellë ekonomike dhe ndihma janë elemente të rëndësishme të saj. Islami vendosi sistemin e sigurimit psiko-shoqëror.

Anëtarët e familjes pra, duhet të integrohen brenda saj, kurse anëtarët e moshës madhore nuk do të duhej të ikin nga anëtarët e moshuar të familjes. Bonjakët, vetëm atëherë kur është e domosdoshme, duhet strehuar në jetimore. Të varfërin dhe të papunësuarin nuk duhet lënë të jetojë nga lëmosha. Të gjitha këto probleme të përshkruara si shembuj të zënë ngoje, gjejnë zgjidhje brenda familjes së rregulluar, që duhet të jetë humane dhe fisnike në plotësimin e nevojave të çdo individi. Ky nuk është vetëm sakrifikim ekonomik, por edhe kujdes i obligueshëm për të gjithë, ndjenjë ndaj nevojave dhe furnizimit të tyre.³⁵

Roli shoqëror i familjes bëhet i rëndësishëm në kontekst të urdhrit të theksuar në Kur'an për poli-gaminë. Poligamia e kufizuar është e lejueshme në Islam, meqë kjo është fe praktike e orientuar në ndërtimin e njeriut prej mishi e ashti. Njerëzit mund të jenë në pozitë që i detyron të jetojnë në monogami, por mund të ballafaqohen me pasoja morale të padëshirueshme. Epshi seksual nuk është i njëjtë te të gjithë njerëzit, e as që kanë aftësi të njëjtë që në këtë kuptim të kontrollohen. Për shkaqe të shumta njeriu mund t'u ekspozohet situatave, ku ose duhet të vendosë për martesë të dytë ose të bëjë mëkate. Në raste të këtilla poligamia është e lejueshme.³⁶

³⁵ Familja është lidhja e parë në sistemin islam të mbrojtjes. Lidhjet tjera i inkuadrojnë institucionet shoqërore dhe sistemin e drejtësisë në sistemin e përgjithshëm të mbrojtjes për të gjithë.

³⁶ Ka njerëz, qëllimi i të cilëve është poligamia dhe atë e pranojnë si mënyrë të sjelljes. Shumëkush habitet kur dëgjon për ndonjërin se i ka dy gra ligjore, kurse, nga ana tjetër, të kenë shumë dashnore e

Ngjashëm me këtë mund të theksohet situata familjare ose shoqërore, duke marrë vetëm disa motive shoqërore. Ekzistojnë periudha, posaçërisht pas luftërave kur gratë (meqë edhe në sistemin e luftës më moderne meshkujt pësojnë më tepër) gjenden në një shoqëri me numër të madh të meshkujve të humbur, ndaj në këto raste shumë gra, nëse nuk integrohen në sistemin e familjes së poligamisë, ose duhet të mbeten të veja ose të jetojnë në mëkate. Islami në këto raste i jep përparësi integritet të grave në familje. Një qëndrim i këtillë në funksionin shoqëror e përmirëson baraspeshën shoqërore. Po ashtu jetimat duhet të mbeten në familje ose në shoqëri, prandaj familja është e obliguar që për ta të kujdeset me dashurinë, me kujdesin dhe me dinjitetin që u takojnë.

konsiderojnë si mburrje. Kundërthënia ndërmjet këtyre dy qëndrimeve shpesh nuk merret parasysh. Ndoshta do të ishte mësim ta citojmë zonjën Anie Bizent për këtë lëndë, e cila thotë: “Në Perëndim lavdërohen me monogami të rrejshme, por, në të vërtetë ekziston poligamia pa asnjë përgjegjësi. Dashnorja lihet atëherë kur i bezdiset mashkullit dhe në këtë mënyrë ajo nxirret në rrugë, duke i takuar kështu femrave të rrugës. Dashnori i saj i parë nuk ndjen kurrfarë përgjegjësie për të ardhmen e saj, ndaj mund të themi se ajo femër është në pozitë shumë më të keqe se sa gruaja e dytë në familjen ku ekziston poligamia. Kur i shohim këto femra që enden rrugëve gjatë natës, te ne paraqitet një mburrje që kjo dukuri nuk ekziston në familjen islame. Poligamia prapëseprapë është më e mirë për gruan. Më mirë është për gruan të jetojë në poligami me një burrë dhe me fëmijë ligjorë se sa të dalë në rrugë dhe të mos kujdeset as për veten, e lëre më për familjen e saj. (Shih Ani Bizent: “The life and teachings of Muhamed”. Madras 1932, f.3).

Kaptina e Kur'anit që lejon poligaminë u shpall pas Luftës së Uhdit, kur u vranë dhjetë për qind të luftëtarëve muslimanë, kështu që u paraqit problemi i jetimave dhe i grave të veja. Edhe pse leja është parimore, konteksti historik flet për veprimin e këtij institucioni. Kur'ani thotë:

“Dhe nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakëve, kurorëzohuni me gratë që ju pëlqejnë, dy, tri ose katër, e nëse frikësoheni se nuk do të mund të jeni të drejtë me më tepër se një, atëherë jetoni vetëm me një apo me atë që me të drejtë e posedoni. Kjo është rruga më e mirë që të mos bëni padrejtësi”.³⁷

Bashkësia martesore trimëron shtimin e mbrojtjes së të dobtëve në gjirin familjar. I Dërguari i Zotit shpjegonte në mënyrë të njerëzishme për gëzimet e njeriut të ri që martohet me vejushën më të vjetër se vet ai, meqë ai kishte pasur motra më të reja që kanë gjetur në të zëvendësimin e nënës së vdekur, prandaj ky i ri në të vërtetë ka dëshiruar të martohet me gruan që mund të kujdeset për edukimin e duhur të motrave të tij. Familja në skemën islame të jetës sjell siguri ekonomike dhe shpie në integrimin dhe kohezionin e marrëdhëniesve. Prandaj, integrimi i saj është mjaft largpamës, duke e humanizuar edhe më tepër sistemin e sigurimit ekonomik-shoqëror.

³⁷ Shih Kur'anin 4:3. Shih gjithashtu edhe polemikën për poligaminë nga Ahmed Hurshidi “Studies of the family lov in Islam”, Karaçi, Chiraghe Rah Publications 1961.

DH. ZGJERIMI E HORIZONTIT FAMILJAR DHE KONTRIBUTI I KOHEZIONIT SHOQËROR NË BASHKËSI

Bashkësia martesore po ashtu përvijon drejt zgjerimit të marrëdhënieve individuale, duke zhvilluar afrinë ndërmjet grupeve të ndryshme dhe të shumanshme, ndërmjet familjeve, fiseve dhe popujve. I Dërguari i Zotit thotë: “Lidhjet martesore ndërmjet dy familjeve apo fiseve e forcojnë miqësinë më shumë se çdo gjë tjetër”.³⁸ Lidhjet martesore janë si ura ndërmjet familjeve, fiseve dhe bashkësive të ndryshme dhe instrument që me zgjerimin e marrëdhënieve familjare vendos barazi ndërmjet njerëzve. Në praktikë lidhja martesore kishte rol të rëndësishëm në periudhën e hershme islame, por po ashtu edhe gjatë historisë së Islamit pati rëndësi edhe në të gjitha viset e Botës islame.

E. MOTIVI PËR PËRPJEKJE DHE SAKRIFICË

Martesa në mënyrë të drejtpërdrejtë frymëzon zhvillimin e ndjenjave për përgjegjësi dhe shkakton paraqitjen e vështirësive të përhershme për plotësimin e nevojave jetësore dhe përmirësimin e zhvillimit ekonomik. Këto aspekte gjenden edhe në porositë e Kur’anit, që i nxisin njerëzit të martohen, ku thuhet:

³⁸ Muskati

“Martohuni me ato gra që gjenden në mesin tuaj e që janë të pamartuara, kurorëzoni robërit tuaj të ndershëm, burrat dhe gratë. Nëse janë të varfër, All-llahu do t’i pasurojë. All-llahu është i pasur dhe i gjithëfuqishëm.”³⁹

Ekzistojnë disa funksione të rëndësishme që zbatohen në familjet e shoqërisë islame. Familja është instanca më besnike e vazhdimësisë dhe lindjes së racës njerëzore. Ajo është mbrojtëse e moralit të individit dhe krijon kontekst shembullor për ndjesi shpirtërore, për kryerjen e obligimeve martesore, e njëkohësisht i obligon të gjithë anëtarët tjerë të familjes për nxitjen e dashurisë, miqësisë dhe të qetësisë në shoqëri. Marrëdhëniet martesore shpiejnë edhe në përparimin gradual të arsimimit. Martesa është hallka e fundit në sigurinë e sistemit shoqëror-ekonomik. Ajo vazhdimisht e nxit njeriun dhe i forcon synimet dhe përpjekjet për progres shoqëror, me anë të të cilin gjeneratat e reja mund të inkuadrohen më lehtë në shoqëri. Ajo është hallka që lidh të kaluarën me të tashmen dhe hap rrugë për ardhmërinë e shoqërisë si dhe bën ndërrimin e gjeneratave përmes proceseve të shëndosha e stabile. Prandaj martesa, në radhë të parë është mjet që i rregullon raportet ndërmjet gjinive dhe siguron mekanizmin me të cilin raporti i familjes është caktuar në bashkësi, kurse në radhë të dytë, ajo është themel i bashkësisë në integrimin e anëtarëve brenda shoqërisë në një tërësi dhe aftësimin e saj për ta realizuar rolin e vet kulturor dhe ideologjik në rrethin e saj. Martesa si e këtillë, është një institucion familjar gjithëpërfshirës.⁴⁰ Nëse ky institucion dobësohet ose shkatërrohet, atëherë do të

³⁹ Kur’ani 24:32

⁴⁰ Sejid Amer Ali parafrazon mendimin e juristëve më të njohur islamë nga veprat e tyre siç janë: “Ashab”, “Darul Muhtar”, “Raddul Muhtar” kështu: “... bashkësia martesore s’është krijuar me qëllim që ta ruajë

rrezikohet ardhmëria e tërë civilizimit dhe kulturës njerëzore. Roli kyç në zhvillimin shembullor të familjes qëndron në mënyrën e sjelljes së gruas. Në shoqërinë islame, ajo lirohet nga mundimi i pamëshirshëm lidhur me furnizimin në jetën martesore dhe mbajtjen e kujdesit për nevojat e punësimit dhe të punës jashtë shtëpisë. Ajo kryesisht i është përkushtuar familjes dhe fëmijëve si dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Ajo është gjithmonë përgjegjëse për marrëdhënie dhe sjellje më të mira në familje. Ajo kujdeset për nevojat e shtëpisë si dhe për nevojat fizike dhe edukative. Familja vetvetiu është një botë që ngërthen aktivitete të shumta intelektuale, fizike dhe punë me karakter organizativ. Ajo pandërprerë i harmonizon dhe i drejton me përgjegjësi dhe autoritet të plotë punët në këtë institucion.⁴¹

njerëzimin dhe njerëzit ta ruajnë veten nga prishja dhe ajo nuk është kurrfarë sakramenti, por e ruan pastërtinë e vet nga ditët e para të paraqitjes - prej h. Ademit. Bashkësia martesore është akt i ibadetit - lutjes, ajo është mjet që e ruan shoqërinë njerëzore nga të gjitha të këqijat që dalin nga marrëdhënia jashtëmartesore. Bashkësia martesore trajtohet si marrëveshje e dy palëve, bashkëjetesa ndërmjet të cilëve nuk ka pengesë ligjore dhe nuk i jep burrit të drejta mbi personalitetin e gruas. (Shih Sejid Amer Ali “Ligji i Muhammedit”, citat nga faqja 241);

⁴¹ Prof. Seid Hysein Nasr thotë: “Në amvisëri gruaja udhëheq si mbretëreshë, kurse burri është furnizues i ndërgjegjshëm i gruas në shtëpi. Shtëpia dhe struktura e familjes së madhe ku jeton ajo, për femrën muslimane është botë e veçantë. Të ndahet me të, do të thotë të ndahet me jetën e vet, që i ngjason vdekjes. Ajo gjen kuptimin e ekzistencës së saj, ashtu që të mund t’i plotësojë nevojat e saj maksimalisht. Sheriati ka paraparë rolin e burrave dhe të grave duke i ndjekur dëshirat e tyre që plotësohen në mënyrë të ndërsjellë. Me anë të marrëveshjes së dyanshme i plotësojnë detyrat e njërit ndaj tjetrit. (Shih S.H. Nasr: “Ideal and Realities of Islam”, Londër 1966,113).

IV. FAMILJA STRUKTURA, PARIMET DHE RREGULLAT

Vazhdojmë me shqyrtimin që në mënyrë thelbësore do t'i tregojë pikëpamjet islame ndaj jetës, institucionit të familjes në Islam, realitetin dhe funksionin e saj. Në këtë pjesë përfundimtare do të përpiqemi të japim një shpjegim të thuktë të veprimit real të institucionit të familjes në Islam, strukturën, parimet dhe rregullat e saj.

BASHKËSIA MARTESORE DHE SHKURORËZIMI

Bashkësia si institucion shoqëror, në thelb vendoset si kontratë qytetare. Në kurorëzim vendoset marrëveshja, që është identike me të gjitha marrëveshjet tjera qytetare. Vlera e saj varet nga aftësia e palëve të marrura vesh, që në pajtim me Ligjin islam duhet të jenë (BULUG) apo të moshës madhore dhe të aftë të gjykojnë drejt (dmth. psikikisht të shëndoshë). Krahas kësaj, nevojitet edhe pëlqimi i dyanshëm dhe deklarata publike, që marrëveshja të mund të jetë e plotfuqishme. Ligji nuk insiston në ndonjë formë të veçantë të marrëveshjes, e as në ndonjë ceremonial të veçantë fetar, kështu që pikërisht për këtë ekzistojnë forma të ndryshme tradicionale që praktikohen ndër muslimanët në vende të ndryshme të botës, e që konsiderohen të preferueshme, sepse ndikojnë pozitivisht. Derisa Sheriati të aplikojë vlerën e kurorëzimit, ai është i varur prej deklaratave të prera të dy partnerëve nga njëra anë (IXHAB) dhe pranimit (KABUL), nga ana

tjetër. Kjo ofertë dhe pranimi i saj (me deklarata të prera) mund të bëhet drejtpërdrejt mes çiftit bashkëshortor, por mund të kryhet edhe përmes ndërmjetësit (VEKIL). Tradicionalisht te muslimanët është zakon që kurorëzimi të kryhet me pajtimin e të fejuarës dhënë përmes ndërmjetësit, që përfaqësuesi do ta paraqesë në gjyqin e Sheriatit. Është normale se gjatë aktit të kurorëzimit duhet të marrin pjesë më së paku dy dëshmitarë, që nënshkruhen në marrëveshjen martesore, duke marrë pjesë kështu në ceremonialin e formimit të familjes. Është e domosdoshme gjithashtu dhurata e kurorëzimit (MEHR), me të cilën bashkëshorti manifeston kujdes dhe respekt ndaj gruas së vet të ardhme, dhe e cila (mehri) është e drejtë e vetme e saj dhe qëndron në disponim të lirë të saj. Është botëkuptim i gabuar që gruaja mund të blihet nga babai ose prindërit e burrit. Lartësinë e dhuratës (MEHR-it) para lidhjes martesore e cakton vetë çifti bashkëshortor dhe kjo shkruhet në marrëveshje. Babai apo ai që kujdeset, mund të ndërhyjë vetëm nëse e fejuara nuk është BULUG (e moshës madhore), ndërsa sipas konstruktit trupor ajo është e pjekur për martesë, mirëpo edhe atëherë mehri i takon vetëm gruas dhe ajo është e drejtë e saj ekskluzive. Dhurata e kurorëzimit është njëri ndër faktorët kryesorë në jetën bashkëshortore, por ajo nuk është qenësore për legalizimin e martesës, që duhet të paracaktohet në sasi të saktë para lidhjes martesore. Mosdhënia e dhuratës martesore nuk e zvogëlon vlerën e kurorëzimit, ndonëse prej bashkëshortit pritet që këtë dhuratë ta realizojë, në pajtim me traditën. Thelbi i marrëveshjes qytetare ndërmjet çiftit bashkëshortor, qëndron në atë se duhet marrë vesh që më parë për të drejtat personale të çdonjërit se ç'bën pjesë në marrëveshje.

Mundësia për ndërprerjen e bashkëshortësisë kushtëzohet me përpjekje të domosdoshme për pajtimin e të dy palëve në mënyra të veçanta (që të shtyhet ndarja e çiftit bashkëshortor), me dëshirë që të hiqet dorë nga shkurorëzimi. Bashkëshortësia në Islam nuk ëshë bashkim kalimtar i gjinive

të kundërta dhe çdo gjë është orientuar në kapërcimin e vështirësive jetësore. Ndërkaq, shkuro-rëzimi i çiftit bashkëshortor është i lejueshëm kur për këtë ekzistojnë arsye objektive dhe atëherë kur shkuro-rëzimi është e vetmja alternativë.⁴² Arbitrariteti familjar është masa e fundit para marrjes së vendimit për shkuro-rëzim definitiv. Kjo preferohet edhe me Kur'an edhe me Sunnet. Nëse kjo nuk ka sukses, atëherë pason vendimi për shkuro-rëzimin e çiftit bashkëshortor. Ekzistojnë tre lloje shkuro-rëzimesh: shkuro-rëzimi kur atë e kërkon burri (TALAK), shkuro-rëzimi kur atë e kërkon gruaja (HULA) dhe shkuro-rëzimi i çiftit bashkëshortor me vendim të gjyqit. Ligjshmëria e plotë për këtë është ndërtuar në bazat e Kur'anit dhe Sunnetit, duke i respektuar në tërësi, kurse përmbledhja e rregullave është shkruar në literaturën e FIKHUT, që i rregullon aspektet e nduarduarta të bashkëshortësisë dhe të jetës familjare.

Martesa muslimane, parimisht është martesë me marrëveshje. Megjithatë, lidhja martesore në radhë të parë është lidhje ndërmjet gjinive të kundërta, në të vërtetë ajo është lidhje ndërmjet dy familjeve e më tepër. Prandaj, anëtarët e familjes, veçanërisht prindërit e bashkëshortëve, luajnë rol të rëndësishëm në formimin e bashkësisë martesore. Pajtimi i të fejuarës dhe të fejuarit është bazë dhe kusht shumë i nevojshëm në lidhjen martesore.⁴³ Përkundër faktit se liria e përzierjes së gjinive është e ndaluar, në rastet kur ekziston qëllimi i kurorëzimit të partnerëve, lejohet që të shi-

⁴² I Dërguari i Zotit ka thënë: “Ndarja e bashkëshortëve është ajo, të cilën ndër gjërat e lejuara All-llahu më së tepërmi e urren”.

⁴³ Në një rast I Dërguari i Zotit ka thënë: “Te vejën mos e kurorëzoni pa e konsultuar, vajzën e re mos e kurorëzoni pa e marrë pëlqimin e saj. Femra në moshën madhore duhet të japë pëlqimin e saj, e nëse nuk e jep, atëherë kurorëzim nuk mund të ketë”. Shih Muskatën, Kurorëzimi pa pëlqimin e vet nuk është i dëshirueshëm në Fenë Islame.

hen e të bisedojnë para martesës, sepse gjatë përgatitjes për kurorëzim në shoqërinë islame nuk marrin pjesë disa angazhime private (edhe pse ka edhe asosh) ndërmjet bashkëshortëve të ardhshëm. Zakonisht e gjithë familja në çdo aspekt i kontribuon plotësisht dhe realizimit të këtij qëllimi.⁴⁴

MARRËVESHJA MARTESORE

Për lidhjen martesore nuk ka rregulla të veçanta ceremoniale. Duhet theksuar se kryerja e martesës bëhet publikisht. Pjesëtarët tjerë të shoqërisë mund të informohen që në njëfarë mënyre është përvetësuar tradita shoqërore (URF). Normalisht, kurorëzimi bëhet në prani të anëtarëve të të dy familjeve dhe miqve. Mirëpo, në shoqërinë muslimane është bërë traditë që personi në fjalë të jetë zyrtarisht i caktuar për këtë punë, siç ishte kadiu (gjykatësi i Sheriatit) që në këtë rast është instancë e përgjegjësive zyrtare. Me rastin e kryerjes së kurorëzimit recitohen pjesë nga Kur’ani, citohen edhe disa thënie të Të Dërguarit të Zotit (sunnete) dhe porositen bashkëshortët që të jetojnë në kënaqësinë e Zotit, në pastërti, me dashuri dhe besim të ndërsjellë si dhe me përgjegjësi shoqërore. Atëherë marrëveshja martesore propozohet (IXHAB) dhe pranohet (KABUL) që të

⁴⁴ Prof. S.H. Nasr ka thënë: “Gruas nuk i ka hije t’i gjejë burrë vetvetes. Ajo nuk duhet t’i ekspozojë bukuritë e veta që ta tërheqë burrin e saj të ardhshëm. Në anën tjetër, burri duhet të jetë mjaft i brengosur nëse i mungon ndonjë rast i mirë, edhe kur nuk vepron me vendosmëri dhe në momentin e duhur të kërkojë grua muslimane të lirë”. Shih: “Idelas and realities of Islam”, citojmë nga faqja 112-113.

kryhet para dëshmitarëve. Pas kryerjes së kurorëzimit nusja me dhëndrin shkojnë në shtëpinë e burrit dhe që të dy fillojnë jetën e tyre të përbashkët bashkëshortore. Është traditë që pas kryerjes së kurorëzimit të çiftit bashkëshortor, sipas mundësisë, burri të bëjë dasmën për të afërmit dhe miqtë e vet. Qëllimi i vërtetë i dasmës dhe i tubimit është njëfarë obligimi shoqëror, me të cilin rast rrethi njoftohet me çiftin e ri bashkëshortor dhe me kontributin e tyre të ardhshëm në shoqëri.

I Dërguari i Zotit i porositi njerëzit që t'u përmbahen këtyre solemniteteve në mënyrë të përshtatshme e të hareshme. Ai ka thënë:

- Dasmë më e mirë është ajo dasmë që shkakton më pak bezdisje dhe sa më pak harxhime,- e pastaj shtoi: “Më të këqija janë ato dasma solemne ku ftohen të pasurit, kurse lihen pasdore të varfërit. Mirëpo edhe ai që nuk e pranon ftesën për solemnitet dasmor, ai i kundërvihet Zotit dhe të Dërguarit të Tij.”⁴⁵

Struktura e familjes përbëhet prej tri pjesëve: 1.Burri dhe gruaja janë më intime dhe fëmijët e tyre, e pastaj prindërit që jetojnë me ta dhe shërbëtorët nëse i kanë; 2. Grupin tjetër e përbëjnë anëtarët e lidhjes kryesore të familjes, e këta janë farefisi i gjerë, pa marrë parasysh se a jetojnë bashkë apo jo, dhe ata që kanë të drejta të veçanta ndaj njëri tjetrit, të cilët lirisht hynë e dalin në familje dhe që nuk mund të martohen ndërmjet vete.⁴⁶

⁴⁵ Shih Muskatën

⁴⁶ Në pjesën e parë të strukturës nuk duhet të harrohen shërbëtorët, sepse edhe ata bëjnë pjesë në familje. Është paraparë se edhe ata duhet të ushqehen, të vishen e të mbathen dhe duhet të trajtohen si anëtarët tjerë të familjes.

Këta janë njerëzit që kanë të drejta të mëdha në pasurinë e atij, në shtëpi të të cilit hyjnë lirisht gjatë jetës së tij, kurse pas vdekjes marrin pjesë si trashëgimtarë të vijës së parë. Këtu është vendimtare që të konsiderohen si MAHRAM dmth. ndërmjet atyre që u janë ndaluar marrëdhëniet martesore. E ndërtuar kështu, krijon bërthamën e familjes me gëzime e hidhërimi, shqetësime dhe besim të përbashkët. Këto marrëdhënie burojnë nga farefisnia e gjakut, farefisnia dhe lidhja e qumështit.⁴⁷

Fisi i bazuar në gjak nënkupton:

A. Babain, nënën, gjyshin, gjyshen dhe të afërmit e tjerë të gjenealogjisë së tërthortë.

B. Gjenealogjinë e drejtpërdrejtë e përbëjnë: bijtë, bijat, nipat, mbesat e kështu me radhë.

C. Të afërmit e shkallës së dytë janë: vëllezërit, motrat dhe vazhdimësia e tyre gjenealogjike. Në formësimin jashtë gjakut bëjnë pjesë: vjehrra (nëna e burrit dhe nëna e gruas), vjehrrri (babai i burrit dhe babai i gruas). II. Bijat e burrit, nipat e tij ose të vajzave apo të djemve të tij;

III. Djemtë e burrit, nipat e djemve të burrit, bijat e burrit dhe IV. Njerka dhe njerku.

Ç. Motrat e nënës (tezet) dhe motrat e babait (hallat, por jo edhe bijtë e tyre dhe të tjerët nga gjenealogjia e gjerë).

⁴⁷ Ne e kemi përdorë fjalën fis për nga qumështi, kurse në arabishte është “elrida’a”. Me këtë nënkuptohet kur gruaja e huaj ushqen familjen, pa marrë parasysh se a rri ajo me të apo nuk rri. Kjo mënyrë e lidhjes familjare ndryshon prej asaj që bëhet me marrjen e fëmijëve bonjakë. Kjo lidhje është gati e njëjtë me lidhjen e drejtpërdrejtë të gjakut dhe gëzon të drejta të trashëgimisë.

Përveç disa përjashtimeve, farefisit të zënë n'goje i ndalohet krijimi i farefisnisë sipas tëmblit (EL'RIDA'AH).

Kjo do të ishte me të vërtetë familje e zgjeruar dhe bërthamë e lidhjeve familjare.⁴⁸ Të gjitha farefisnitë janë jashtë kësaj familjeje të përbërë. Ajo gjithashtu ka disa të drejta dhe detyra të veta siç janë ndihma e ndërsjellë, duke e ditur se janë të lidhur në vijën e dytë e të tretë të trashëgimisë. Struktura e përgjithshme e familjes është pasqyruar në diagramin e poshtëshënuar.

STRUKTURA E FAMILJES MUSLIMANE FAREFISNIA E GJERË FAMILJARE

Bërthama e brendshme e familjes:

- prindërit
- prindërit e prindërve
- burri
- gruaja

⁴⁸ Në shoqërinë islame ekziston bashkëpunimi ekonomik, por ai nuk i lidhë ekonomikisht, e as nuk organizohen në atë mënyrë, e nëse është vendosur marrëveshja, atëherë pranohet kontrolli.

- fëmijët
- shërbëtorët.

Bërthama kryesore e familjes që paraqesin

MEHARIM

- vëllezërit dhe motrat e babait (axhallarët dhe hallat)
- vëllezërit dhe motrat e nënës (dajat e tezet)
- të bijat e vëllait (mbesat)
- të bijat e motrës (mbesat)
- vjehrra (nëna e burrit ose nëna e gruas)
- vjehrri (babai i burrit ose babai i gruas)
- bijat e burrit (thjeshtat)
- bijtë e gruas (thjeshtat)
- gratë e nipave
- njerka, etj.

POZITA E BURRIT DHE E GRUAS

Në organizimin e brendshëm familjar, pozita e burrit është e rëndësishme dhe ai mbikëqyrë gjithçka në familje. Në realitet, ai është anëtari më i vjetër që zë pozitën e përgjegjesisë. Funksioni dhe përgjegjësia kryesore e burrit shtrihen edhe jashtë familjes. Ai është mbrojtës dhe mbajtës i familjes ekonomikisht dhe materialisht. Ai duhet të kujdeset për familjen si pjesë e shoqërisë, duke ia përcaktuar rrugën ekonomikisht si dhe kujdeset për disiplinën e brendshme në familje. Gruas i takon përgjegjësia kryesore për pozitën e brendshme të familjes. Këtu, gjithashtu gruaja më e vjetër është mbikëqyrëse dhe organizatore kryesore e familjes. Mirëpo, gjatë periudhave të caktuara dhe brenda orarit të caktuar të punës, pozitën relativisht kryesore e ka gruaja që caktohet për udhëheqjen e punës përkatëse. Spektri i të drejtave të ndërsjella dhe i përgjegjësive krijohet në atë mënyrë që baraspesha e raporteve të zhvillohet vetëm ndërmjet tyre. Kur’ani thotë:

“Burrat janë mbrojtës të grave, pasi All-llahu i dalloi të parët mbi të tjerët, sepse ata e harxhojnë pasurinë e vet për mbajtjen e familjes së tyre.”⁴⁹

“...Edhe gratë kanë të drejtë si burrat, që janë para tyre e që është në pajtim me drejtësinë, por burrat kanë përparësi para tyre. All-llahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.”⁵⁰

E gjithë kjo është e rregulluar në interes të organizimit sa më të mirë të jetës brenda familjes.

⁴⁹ Shih Kur’anin 4:34

⁵⁰ Shih Kur’anin 2:228

Këtu gërshetohen barazia dhe drejtësia, kurse për qëllim kanë përkufizimin e përgjegjësisë. Burri është caktuar si kryefamiljar dhe si i tillë bën organizimin dhe kujdeset për mbajtjen e familjes. Mirëpo, që të dyve, gruas dhe burrit, u është caktuar që secili ta kryejë detyrën e vet drejt dhe me barazi të plotë. Çështja e barazisë apo e jobarazisë së punëve shtrohet shpesh. Kjo çështje del prej qëndrimeve dhe kulturës së caktuar të kontekstit hohor. Mirëpo, sipas kontekstit islam, barazia e burrit dhe e gruas si qenie njerëzore, është theksuar nga Zoti dhe është garantuar me ligj. Ekzistojnë dallime vetëm në rolet, në përgjegjësitë dhe në ndarjen e punës, që është e orientuar në atë mënyrë që të kënaqen nevojat e organizimit në familje dhe të vendosen jo në bazë të superioritetit ose inferioritetit të një gjinie, por në dritën e faktorëve themelorë të nevojave të jetës.⁵¹ Çdo rol individual vetvetiu është i rëndësishëm dhe çdo bashkëshort vepron në pajtim me përgjegjësinë që i është caktuar. Këto role nuk janë garuese, por e plotësojnë njëri-tjetrin.

⁵¹ Mësimi i trashëgimisë islame është shumë instruktiv në këtë shikim institucioni, sipas të cilit vajzës i takon gjysma e trashëgimisë, e cila i ndahet djalit. Duket se ekziston jobarazi ndërmjet gjinive, por kur kjo shikohet nga aspekti ekonomik dhe përgjegjësia e burrit dhe gruas, shohim se për këtë ka arsytim sepse përgjegjësia për fitim dhe harxhim në familje i takon burrit, derisa gruaja pasurinë e vet mund ta përdorë për nevoja personale. Këto dy lloje imponojnë edhe këtë mënyrë të ndarjes së trashëgimisë. Nëse trashëgimia ndahet jo në baza familjare, atëherë edhe gruas i takon aq sa edhe burrit.

FAMILJA DHE SHOQËRIA

Familja është pjesë përbërëse e rregullimit të shoqërisë islame. Shoqëria, siç kërkon ta organizojë Islami, nuk mund të jetë e shfrenuar e as seksualisht të veprjë në mënyrë anarkike. Islami e organizon shoqërinë, duke e ndërtuar mbi bazën e idealeve dhe besimeve të shumta dhe vetëdijes së lartë morale, me besim të fortë në idealet e hilafetit të caktuar drejt selles humane. Disiplina e tij nuk guxon të jetë e ngarkuar, përveç asaj që sheshazi shmanget nga idetë dhe vlerat e Islami. Në të mbizotëron një shkallë e lartë e përgjegjësisë shoqërore, kurse sistemi i tërësishëm vepron drejt forcimit dhe përkryerjes së familjes.

Familja është e mbrojtur me ndlimin e rreptë të jetës jashtëmartesore dhe të kurvërisë. Të gjitha marrëdhëniet jashtëmartesore si të tilla ndalohen dhe meritojnë dënim të caktuar sipas ligjit. Të gjitha rrugët që shpiejnë në drejtim të kësaj të keqeje, duhet të mbyllen dhe të pengohen. Që të mos ketë huti në çfarëdo mënyre, kurvëria ndalohet. Sistemi islam i HIXHAB-it është vendosur gjerësisht e me të mbrohet familja dhe mbyllen të gjitha shtigjet që shpiejnë drejt marrëdhënieve seksuale kundërligjore.

Këto urdhra janë të rëndësishme dhe shërbejnë si normë dhe rregullatorë për mënyrën e sjelljes dhe të veshjes, si normë për marrëveshjet martesore ndërmjet individëve dhe për shumë çështje të tjera, që janë të përgjithshme apo mund t'u nënshtrohen këtyre urdhrave.⁵²

⁵² Shih Abul Ala Mevdudi: “Purdah and the status of Women in Islam”, 1973, dhe Ali Musa Muhaxhir: “Islam in practical Life”, 1068.

Vlerat më të mira të jetës ofrojnë gjithfarë gëzimi, por njeriu mund të gjendet edhe në kurvëri si kundërshtari më i madh i fatit familjar, ndaj me përpjekje të arsyeshme orientohet drejt asaj që është fisnike dhe e mirë në jetën njerëzore. Andaj edhe ndërmerren masa të ndryshme parandaluese për ta mbrojtur familjen nga ndikimet, që mund ta bastardojnë dhe ta dobësojnë moralin dhe klimën shoqërore të saj. Disa prej këtyre masave gjenden edhe në bindjen e natyrës morale, ndërsa të tjerat kanë formë të normave dhe të sanksioneve shoqërore, kurse disa janë të rregulluara me ligj, të cilat për kundërvajtjet e kryera tërheqin pas vete dënime përkatëse. Të gjitha këto masa mbrojnë familjen dhe i mundësojnë asaj që të luajë rolin vet pozitiv në strukturën e shoqërisë islame.

Martesën dhe familjen në Islam duhet studiuar dhe duhet kuptuar në kontekst të skemës së jetës, që dëshiron ta vendosë Islami. Ato nuk mund të kuptohen të izoluara. Kuptimi i njeriut dhe i familjes që e ofron Islami, ndryshon nga kuptimi i njeriut dhe i familjes që mbizotëron sot në Perëndim. Ne aspak nuk duam që këtu të jemi apologetikë. Ne refuzojmë t'i pranojmë vlerësimet neutrale të qasjes, që deshëm apo s'deshëm rregullojnë jetën dhe pikëpamjet për ardhmërinë e njeriut në civilizimin botëror, siç duket sot në Perëndim. Ne mendojmë se shkatërrimi i familjes në Perëndim, pjesërisht është rezultat i konfuzionit për vendin dhe rolin e familjes në shoqëri dhe për qëllimet e jetës në përgjithësi. Meqë qëllimet dhe vlerat e jetës nuk janë rregulluar siç duhet, shkatërrimi i mëtejme i familjes dhe i intitucioneve të tjera është vështirë të evitohet. Tragjedia e kohës sonë qëndron në ndryshimet që i imponohen njeriut me anë të presioneve teknologjike dhe zbulimeve të tjera të jashtme, si dhe nga procesi i tërësishëm i ndryshimeve që u bënë mjaft komplekse dhe johumane.

Në kohët e lashta kur liria e shërbimit fetar (ibadeti) ishte e barabartë me hyjninë, njeriut i kufizohej liria që të vendosë për idealet e tij, vlerat, ligjet dhe mënyrat e jetës. Detyra parësore në shkallë të parë sot është vendosja dhe kthimi i lirive të humbura dhe gjykimi i shëndoshë e formimi i vlerave sipas nevojave njerëzore, që ata të vihen në rrugë të mbarë. Një nga qëllimet e martesës është lidhja psikike, emocionale dhe shpirtërore ndërmjet burrit dhe gruas, që i përgjigjet natyrës njerëzore dhe sistemit shoqëror. Detyrimi jonjerëzor dhe jomoral, qoftë ai historik ose teknologjik, nuk do të guxonte të vendosë për njeriun, por ai vetë duhet të vendosë për vetveten si mëkëmbës i Zotit në Tokë. Sido që të jetë, ndryshe rezultatet tona në fushën e shkencës dhe teknologjisë do të na shpiejnë kah forma e re e robërisë, ndaj njeriu do të shtrëngohet ta braktisë rolin e vet të vërtetë në këtë botë. Përfundimisht, të gjithë ne që besojmë në Zot, duhet të mbrohemi si njerëz dhe ta organizojmë jetën tonë në sistemin moral të botës.

Në shekullin kur institucionet familjare, nën ndikimin e fuqishëm e destruktiv në botë fillojnë të shkatërrohen, Islami vazhdon të zhvillohet me hov. Nuk ka rrezik nga kërcënimet e as nga ndryshimet, as nga brenda e as nga jashtë, ndaj duhet theksuar se familja muslimane sot mbeti ashtu siç ishte edhe në të kaluarën. Ajo u tregua e ndërtuar mirë dhe jo vetëm që mbijetoi, por edhe përparoi, duke u frymëzuar gjithnjë me jetën (kohën) e re. A është kjo cilësi e historisë shoqërore apo ekziston diç unike në themelet dhe në strukturën e familjes islame? Ky edicion i vogël u përpoq që të japë përgjigje dhe shpjegime për martesën dhe familjen islame dhe për pozitën e saj në strukturën islame të besimit dhe civilizimit.

Autori nga këndvështrimi islam filloi ta kundrojë jetën dhe shoqërinë, duke e përshkruar atë, në kontekstin dhe në themelet e të cilave ekzistojnë institute të strukturës familjare. Ky trajtim është në kuptim dhe në funksion të familjes, strukturës, parimeve dhe rregullave të saj. Familja vepron

si institucion fetar, por gjithashtu ajo vepron edhe si njësi shoqërore. Fuqia e Islamit qëndron në integrimin e besimeve dhe ngjarjeve shoqërore të ndërlidhura në një tërësi jetësore.